

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6767
E premte, 25 nëntor 2022
çmimi 0.40

REAGIM I KMDLNJ-së
**Vazhdon kriminalizimi i
Zyrës së Prokurorit të
Specializuar duke dëmtuar
të akuzuarit** | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

DIALOGU SË SHPEJTI NIS ME PROPOZIMIN FRANKO-GJERMAN

Kryediplomati evropian Josep Borell ka paralajmëruar se në ditët e ardhshme do t'i ftojë liderët e Kosovës dhe të Serbisë për të diskutuar për propozimin franko-gjerman. Edhe kryeministri Albin Kurti ka bërë me dije se procesi i dialogut duhet të fillojë brenda disa ditëve. "Dakordimi i fundit ka një target kryesor dhe kohor për negociimin dhe pajtueshmërinë e palëve lidhur me propozimin e Bashkimit Evropian të mbështetur nga Franca dhe Gjermania", ka thënë Kurti



AKTUALE



**KUVENDI I KOSOVËS PËR
HERË TË PARË PËRFAQËSOHET
NË KOMITETIN E PËRHERSHËM
TË APKE-së** F. 8

**MË 25 DHJETOR ZGJEDHJET PËR
KUVENDET KOMUNALE NË ZVEÇAN
DHE LEPOSAVIO** F. 9

**70-VJEÇARI NË PRISHTINË VRET
ME SËPATË GRUAN 63-VJEÇARE** F. 9

HAPET EKSPOZITA PERSONALE E REXHEP SELIMIT



- Rexhep Selimi përmes punës së tij po tregon që është në mesin tonë, po komunikon me ne përmes artit dhe pikturave që na i ka dërguar prej atje



Pakush e kishte ditur se Rexhep Selimi kishte pasion edhe për pikturën. Ndonëse në Hagë tash e dy vjet, të premtën në Muzeun Kombëtar të Kosovës është hapur ekspozita "Në garë me botën gri", me 110 piktura personale të Selimit. Hapja e kësaj ekspozite vjen pak ditë para 110-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë. Në hapjen e kësaj ekspozite kanë marrë pjesë personalitete të ndryshme politike, kulturore dhe publike. Në fjalën e tij, kryeparlamentari Glauk Konjufca ka thënë se Selimi përmes punës së tij është duke komunikuar me publikun. Në këtë kontekst, Konjufca e ka quajtur të padrejtë mbajtjen në paraburgim të liderëve të UÇK-së, duke thënë se procesi ndaj tyre është stërzgatur

EKONOMI



**KUVENDI I SHQIPËRISË MIRATON
PROJEKTIN PËR PORTIN E DURRËSIT** F. 10

**RITA ORA NË PULLËN POSTARE TË
KOSOVËS** F. 10

SPORT



**FFK-ja ANKOHET NË FIFA PËR VEPRIMIN
AGRESIV TË SERBISË NË BOTËTOR** F. 10

MË 27 NËNTOR MBAHET MBLEDHJA E PËRBASHKËT E KUVENDIT TË KOSOVËS DHE KUVENDIT TË SHQIPËRISË

 | FAQE 8

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANKIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Macroni përballet me probleme të mundshme ligjore për konsulentët

PARIS, 25 NËNTOR - Presidenti francez Emmanuel Macron përballet me probleme të mundshme ligjore pasi prokurorët njoftuan se po hetonin shërbimet e kompanive konsulente gjatë fushatave zgjedhore kombëtare në vitin 2017 dhe 2022.

Edhe pse në njoftimin e prokurorit financiar nuk përmendet në mënyrë specifike fushata e Macronit, besohet se ekipi i tij zgjedhor është objektiv kryesor i dy hetimeve të veçanta, raporton Agjencia France Presse (AFP). Prokuroria saktësoi se që nga tetori kanë nisur dy hetime për përdorimin e konsulentëve gjatë zgjedhjeve të vitit 2017 dhe të vitit 2022.

Siç raporton AFP-ja, këto shërbime konsulente kanë qenë në qendër të vëmendjes që nga marsi i këtij viti pas një hetimi nga Senati francez, i cili arriti në përfundimin se shpenzimet publike për tu

dyfishuan nga viti 2018 në vitin 2021, gjatë mandatit të parë të Macronit.

Shuma e përgjithshme arriti në më shumë se 1 miliard euro (1.1 miliard dollarë) vitin e kaluar, të cilën shifër e kanë cituar shpesh kundërshtarët e Macronit, gjatë fushatës së tij të prillit, raporton AFP.

Faaja e internetit hulmuese e lajmeve Mediapart, raportoi se konsulentët nga firma amerikane McKinsey punuan falas në fushatën e Macron në vitin 2017.

Kabineti i presidentit francez njoftoi se "sistemi gjyqësor është i obliguar që këto hetime t'i kryejë në mënyrë plotësisht të pavarur".

AFP-ja raporton se prokurorët do të hetojnë akuzat që kanë të bëjnë me llogaritjen e mundshme të rreme të fushatës zgjedhore dhe nënvlerësimin e kostove të fushatës, si dhe favorizimet e mundshme dhe komplotet në favorizim.



Franca ka rregulla rigoroze të financimit të fushatës, të cilat vendosin kufizime në atë që

një kandidat mund të përdorë. Për zgjedhjet presidenciale të vitit 2022, çdo kandidat kishte

maksimalisht 16.8 milionë euro për rundin e parë dhe 22.5 milionë euro për rundin e dytë.

NATO-ja zotohet se do t'i ndihmojë Ukrainës "për aq kohë sa të ketë nevojë"

BRUKSEL, 25 NËNTOR - Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, u zotua të premtën se aleanca veri-atlantike do t'i ndihmojë Ukrainës të mbrohet në luftën kundër Rusisë "për aq kohë sa të ketë nevojë". Ai, gjithashtu, tha se NATO-ja do t'i ndihmojë vendit të shkatërruar nga lufta t'i transformojë forcat e armatosura në një ushtri moderne sipas standardeve perëndimore.

Në një konferencë për media para takimit të ministrave të Punëve të Jashtme të NATO-s, që do të mbahet javën e ardhshme në Rumani, Stoltenberg kërkoi nga vendet anëtare që, ose individualisht ose në formë grupore, të vazhdojnë t'i ndihmojnë Ukrainës me armë dhe sisteme të mbrojtjes ajrore. NATO-ja, si organizatë, nuk dërgon armatim. "NATO-ja do të vazhdojë të qëndrojë pranë Ukrainës për aq kohë sa të ketë nevojë. Ne nuk do të tërhiqemi", është shprehur ish-kryeministri i



Norvegjisë. "Aleatët janë duke dërguar në mënyrë të paprecedentë mbështetje

ushtarake dhe unë pres që ministrat e Punëve të Jashtme do të pajtohen ta rrisin edhe

mbështetjen jo-vdekjeprurëse". Stoltenbergu ka thënë se anëtarët e organizatës 30-kombëshe të

sigurisë i kanë ndihmuar Ukrainës me karburante, gjeneratorë, furnizime mjekësore, pajisje për dimër dhe pajisje për bllokimin e dromëve, veçanërisht tani që Rusia e ka sulmuar infrastrukturën e energjisë në Ukrainë. "Në takimin tonë në Bukuresht, unë do të bëj kërkesë për edhe më shumë. Në periudhën më afatgjate, ne do t'i ndihmojmë Ukrainës të kalojë nga pajisjet e kohës Sovjetike në standardet, doktrinat dhe trajnimet moderne të NATO-s", ka thënë ai.

Stoltenbergu ka theksuar se ministri i Punëve të Jashtme të Ukrainës, Dmytro Kuleba, do t'i bashkohet grupit të ministrave për të diskutuar rreth nevojave më urgjente të vendit të tij, por edhe të diskutohet se çfarë mbështetje afatgjate mund të ofrojë NATO-ja.

Shefi i NATO-s ka pohuar se kjo mbështetje do t'i ndihmojë Ukrainës drejt anëtarësisimit në këtë aleancë në të ardhmen.

Ukraina dhe Rusia këmbajnë rreth 100 të burgosur

Kiev, 25 nëntor - Ukraina dhe Rusia kanë këmbyer rreth 100 të burgosur, nga 50 prej secilës palë. Kreu i zyrës presidenciale ukrainase, Andriy Yermak, konfirmoi se

50 të burgosurit e kthyer ukrainas janë edhe të mbijetuar nga rrethimi i fabrikës së hekurit dhe çelikut, Azovstal. Ministria ruse e Mbrojtjes dhe

kreu i separatistëve të mbështetur nga Rusia në rajonin e Donjeckut, Denis Pushilin, konfirmuan se forcat ukrainase i kishin dorëzuar palës ruse 50 të burgosur. Ky

këmbim u bë një ditë pas një tjetër këmbimi që ndodhi mes Kievit dhe Moskës, ku 36 persona - 35 ushtarë dhe një civil u kthyen në Ukrainë, dhe 35 ushtarë rusë u riatdhësuan.



Reagim i KMDLNj-së

Vazhdon kriminalizimi i Zyrës së Prokurorit të Specializuar duke i dëmtuar të akuzuarit



Së fundi doli në opinion edhe një skandal, sigurisht edhe jo i fundit i Zyrës së Prokurorit të Specializuar për hetim, arrestim, gjykim dhe dënim ekskluzivisht në baza etnike. ZPS-ja shkeli ligjin pasi ndikoi që Gjykata Speciale Raciste në Hagë, në mënyrë të kundërligjshme e bëri publike një aktakuzë të pakonfirmuar për të arsyetuar arrestimin e kundërligjshëm të krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Veprim skandaloz kundër të drejtave të njeriut të personave të privuar nga liria. Ndonëse nuk ishte asgjëkundi me dosje paraprake, iu bëri presion mbrojtjes, të akuzuarve, familjarëve, opinionit dhe vet Gjykatës se do të jetë e gatshme për fillim të gjykimin në shtator të vitit 2021 në ndërkohë që as sot nuk është e gatshme për ta nisur procesin. Kërkoj 1869 orë për të prezantuar dhe mbrojtur aktakuzën, kohë që nuk e pati as Tribunali Ndërkombëtar për Krime Luftë për ish-Jugosllavinë thuaja për të gjitha rastet. Shpiku dëshmitarë pa adresa, pa identitet sikur që futi në listën e

dëshmitarëve edhe persona të vdekur. Futi në listën e dëshmitarëve e që intervistuan persona që në kohën e luftës ishin të moshës së një fëmije, pa i mbushur 10 vjet. Aq shumë e redaktoi aktakuzën duke bërë përpjekje që maksimalisht ta pamundësojë mbrojtjen efektive të të akuzuarve duke e vënë Gjykatën para aktit të kryer. Në mënyrë të paskrupullt, të pamoralshme dhe në kundërshtim të çdo dinjiteti dhe integriteti profesional i fshehu provat shfajësuese për të akuzuarit sikurse refuzoi të gjitha garancitë e shteteve tjera se do të siguronin realizimin e masës së shqiptuar, në përputhje me standardet dhe Rregulloren e ZPS-së. Bashkëpunoi jashtë çdo kriteri profesional me organet e sigurimit të Serbisë që kishin përgjegjësi konkrete dhe faktike, qoftë si ekzekutues të drejtpërdrejtë, qoftë si urdhërdhënës në bazë të përgjegjësisë hierarkike ushtarake dhe policore për ekzekutimin e civilëve shqiptarë, zhdukjen e kufomave dhe asgjësimin e tyre

në ndërkohë që kundërshtoi të merren për shqyrtim kërkesa e mbrojtësve për listën e masakrave kundër civilëve në Kosovë, si dëshmi në favor të të akuzuarve. U përpoq panjerëzishëm që viktimat t'i ndajë në baza fetare duke pohuar se krimet janë bërë për shkak të përkatësisë fetare e jo etnike. Me vonesë shumë të madhe dhe në mënyrë selektive përktheu materialet e kësaj zyre në mënyrë që të pakësojë mundësitë për përgatitje të mbrojtjes së të akuzuarve. Së fundi doli në pah inskenimi i radhës kundër të të akuzuarve dhe mbrojtjes së tyre duke bashkëpunuar dhe duke përgatitur dëshmitarët e rrejshëm që ishin rekrutuar nga një njeri i shërbimit sekret serb i cili kishte sjellë dëshmitarë dhe dëshmi të rrejshme e që kjo Zyrë e Inkuizicionit i kishte marrë të mirëqena duke i përfshirë edhe në aktakuzë. KMDLNj nga distanca sepse nuk i ishte lejuar monitorimi nga afër pikërisht nga kjo Gjykatë sikur që ishte dhe po pengohet nga

institucionet e Kosovës, ka monitoruar të gjitha aktivitetet të cilat i ka përfshirë në raport dhe reagimet e shumta duke kërkuar nga deputetët e Kuvendit të Kosovës që të kërkojnë transparencë dhe llogaridhënie, pa interferuar në punën e kësaj gjykate e që, deri më tani nuk e kanë bërë! Nëse Gjykata Speciale është votuar në Kuvendin e Kosovës dhe nëse edhe inkuizitorët e kësaj gjykate ku ZPS-ja është pjesë përbërëse e thonë publikisht se janë pjesë e sistemit të drejtësisë së Kosovës, pse atëherë deputetët e Kuvendit të Kosovës nuk paskan të drejtë ta ngre këtë çështje, si çështje e të drejtave të njeriut të personave të privuar nga liria, të gjithë shtetas të Kosovës dhe të gjithë shqiptarë?! Deputetët e Kosovës kanë mandat dhe detyrim të përfaqësojnë dhe mbrojnë interesat e qytetarëve të Kosovës në të gjitha rrethanat dhe vendet, pavarësisht statusit që e kanë ata qytetarë dhe këtë nuk po e bëjnë. Sikur edhe institucionet tjera përgjegjëse. Ose, e bëjnë në mënyrë selektive, diskriminuese

në baza të pëlqimit politik apo urrejtjes që e kanë ndaj tyre, i vizitojnë apo nuk i vizitojnë duke përfutur politikisht dhe materialisht. Përveç rrogës, marrin edhe mëditje për punën që nuk e bëjnë, as sipas mandatit, etikës profesionale dhe betimit që e bëjnë si përfaqësues të popullit. KMDLNj tërheq vërejtjen se me mosveprimin e tyre, deputetët e Kuvendit të Kosovës sikur edhe përfaqësuesit e qeverisë së Kosovës po e përlligjin kriminalizimin e Zyrës së Prokurorit të Specializuar duke shkelur në mënyrë flagrante të drejtat e njeriut të personave të privuar nga liria e që garantohen me të gjitha dokumentet kombëtare dhe ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Një institucion që ka përgjegjësi për votim të ligjeve e që është Kuvendi i Kosovës, që thirret në transparencë dhe llogaridhënie, nuk ka guxim e as vullnet të kërkojë transparencë dhe llogaridhënie nga një institucion të cilin vet e ka themeluar, Gjykatën Speciale Raciste në Hagë. Turp!

Sekuestrohen 430 kg kokainë në një fshat të Shqipërisë

PRISHTINË, 25 NËNTOR - Rreth 430 kilogramë kokainë, e cila ka qenë e fshehur në 24 tonë pleh organik artificial, është sekuestruar në fshatin Farkë e Madhe në Fier të Shqipërisë, u tha në konferencën për medie të Strukturës së Posaçme kundër Krimit të Organizuar

dhe Korrupsionit (SPAK) të mbajtur më 25 nëntor në Tiranë. Kjo kokainë ka ardhur në Shqipëri nga Kolumbia, duke kaluar transit nëpër dy porte, të Greqisë dhe Malit të Zi. Vlera e saj, nëse do të dilte në treg, do të ishte rreth 40 milionë euro.

Hetimet janë realizuar mes autoriteteve shqiptare dhe malazeze si dhe në bashkëpunim me agjenci të huaja ligjzbatuese, që kishin nisur në korrik të këtij viti. Ky aksion në Mal të Zi u krye me kodin "Port" e në Shqipëri me kodin "Konsistenca".





Hapet ekspozita personale e Rexhep Selimit

- Rexhep Selimi përmes punës së tij po tregon që është në mesin tonë, po komunikon me ne përmes artit dhe pikturave që na i ka dërguar prej atje

Pakkush e kishte ditur se Rexhep Selimi kishte pasion edhe për pikturën. Ndonëse në Hagë tash e dy vjet, të premtën në Muzeun Kombëtar të Kosovës është hapur ekspozita “Në garë me botën gri”, me 110 piktura personale të Selimit. Hapja e kësaj ekspozite vjen pak ditë para 110-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë. Në hapjen e kësaj ekspozite kanë marrë pjesë personalitete të ndryshme politike, kulturore dhe publike. Në fjalën e tij, kryeparlamentari Glauk Konjufca ka thënë se Selimi përmes punës së tij është duke komunikuar me publikun. Në këtë kontekst, Konjufca e ka quajtur të padrejtë mbajtjen në paraburgim të liderëve të UÇK-së, duke thënë se procesi ndaj tyre është stërzgatur

prej atje. E patë edhe ju, dhe dua të ndaj disa kujtime sa i përket momentit kur për herë të parë mora vesh që Rexha ka filluar të pikturojë. Ishte befasi, viti 2016, jo fort moti ,kur Rexha ma dërgoi pikturën e tij të parë, në telefon. Më duket kam qenë në Shqipëri. Tha çka mendon për këtë pikturë? Me aq sa kam njohuri edhe për artin tonë kosovar, thashë kjo me siguri duhet të jetë një pikturë e Simon Shirokës, përafërsisht”, ka thënë Konjufca.

Më tutje, Konjufca ka folur për liderët e tjerë të UÇK-së, Hashim Thaçin, Kadri Veselin dhe Jakup Krasniqin. “Ai (Selimi) i ka dërguar

prej Hagës atje ku po gjykohet, por ku ende nuk ka filluar gjykimi. Po akuzohet pa aktakuzë së bashku me bashkëveprimtarë të tjerë, me ish-kryetarin e Kuvendit, Krasniqi, me ish-kryetarin e Kuvendit, Veseli, me ish-presidentin Thaçi. Jemi të vetëdijshëm si popull për drejtësinë dhe pastërtinë e luftës sonë çlirimtare”, ka thënë Konjufca.

Më tutje, Konjufca e ka quajtur të padrejtë mbajtjen në paraburgim të liderëve të UÇK-së, duke thënë se procesi ndaj tyre është stërzgatur. Sipas Konjufcës, gjatë fazës paraprake të akuzuarit kanë mundur të qëndrojnë në liri. “Po quhet një proces gjyqësor, por gjykimi nuk ka filluar ende. Është zgatur shumë, me të vërtetë. Unë e kam shprehur shqetësimin dhe pakënaqësinë time pse kjo po ndodh. Kanë kaluar më shumë se dy vjet dhe nuk po fillon gjykimi. Është e pashpjegueshme dhe e padrejtë në të njëjtën kohë, sepse unë mendoj që po shkelen të drejtat e njeriut. Ata, faktikisht, deri tash kishin mundur me u mbrojt në liri e kur të fillonte gjykimi gjykata mund ta rivlerësonte edhe një herë dhe ta rishqyrtonte çështjen e mbajtjes së tyre, po me vetë faktin që kjo

**EPOKA
ERE****Lirim GECI**

25 NËNTOR - Në vigjilje të 28 Nëntorit, Ditës së Flamurit, të premtën në Prishtinë është hapur ekspozita personale “Në garë me botën gri” e Rexhep Selimit, i cili është një nga themeluesit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Selimi tash e dy vjet gjendet në paraburgim në Hagë, por kjo nuk e ka penguar që ta shfaqë talentin edhe në pikturë. Ekspozita e Selimit përmban 110 piktura të cilat janë punuar me mjeshtri nga ai në një periudhë katërvjeçare. Dhjetëshi i UÇK-së në dy vjetët e fundit është duke komunikuar me publikun përmes artit të tij, që një pjesë të konsiderueshme të kohës e kalon duke pikturuar dhe e shkruar poezi e tekste këngësh. Në hapje të kësaj ekspozite kanë

marrë pjesë personalitete të ndryshme të jetës politike (pozitë dhe opozitë), akademike dhe kulturore. Po ashtu, në hapje të kësaj ekspozite kanë marrë pjesë edhe familjarët e Selimit. Në fjalën e tij, kryetari i Kuvendit të

Kosovës, Glauk Konjufca, ka thënë se Selimi disa nga pikturat i ka dërguar nga Haga. “Rexhep Selimi përmes punës së tij po tregon që është në mesin tonë, po komunikon me ne përmes artit dhe pikturave që na i ka dërguar






nuk po ndodh dhe kemi izolim të tyre që dy vjet pa filluar gjykimi, tregon që diçka nuk është në rregull”, ka thënë Konjufca në hapjen e ekspozitës së Rexhep Selimit, i cili është duke u mbajtur në paraburgim në Hagë. Ai ka thënë se ky proces duhet të përfundojë sa më shpejt dhe të vërtetohet lufta e pastër e UÇK-së. “Urojmë që ky proces sa më shpejt të përfundojë e të dalë në shesh ajo që, faktikisht, në shesh ka qenë gjatë gjithë kohës, që është e vërteta për luftën tonë të drejtë. Që lufta jonë ka qenë popullore, mbrojtëse, çlirimtare dhe ka qenë e drejtë dhe e pastër. Agresori dihet kush ka qenë.

Ka qenë Serbia e cila ka shkuar gjenocid mbi popullin tonë”, ka deklaruar Konjufca. Ndërsa bashkëshortja e Rexhep Selimit, deputetja Shqipe Selimi, ka thënë se pret që ai dhe bashkëluftëtarët e tij të kthehen sa më shpejt në Kosovë. “Sot nuk dua të flas më shumë, sepse këtu më shumë flasin piktorat e ekspozuara. Më vjen mirë që edhe unë kam dhënë një kontribut duke i bartur nga Haga në Kosovë. Vlerën artistike unë mund ta jap, por këtë e bën të veçantë vendi dhe koha ku janë realizuar. Presim që Rexha dhe të akuzuarit të tjerë të kthehen”, ka thënë ajo.

Për piktorat e Selimit më herët kishte folur edhe miku i tij, publicisti Muhamet Mavraj, i cili më 1 tetor e kishte vizituar atë, Hashim Thaçin, Kadri Veselin dhe Jakup Krasniqin. Mavraj në një intervistë televizive kishte thënë se, mbase, Rexhep Selimi është duke e ndërtuar mbrojtjen nëpërmjet pikurës. Në këtë kontekst Mavraj ka thënë se nuk e kishte ditur se Selimi merrej edhe me pikurë. “Nuk e kam ditur, sepse nuk është bërë llaf përpara. Për poezinë po, për tekstet e këngëve po. I etshëm të provojë gjera të reja, ndryshime, i kishte hyrë edhe pikurës dhe sa unë kuptova, ende nuk e ka gjetur



stacionin e vet. Ende është në kërkim të vetvetes. Si poezia ashtu edhe pikura thjesht si arte janë si gjuhë e dytë, gjuhë e tretë e komunikimit. Na thotë diçka me poezi, na thotë diçka me ngjyra, me ato përdëllimet estetike të ngjyrave dhe, mbase, mbase,

mbrojtjen e vet është duke e ndërtuar nëpërmjet pikurës”, ka thënë Mavraj. Ekspozita e Rexhep Selimit është mbështetur nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Kjo ekspozitë do të jetë e hapur deri më 4 dhjetor.



Dialogu së shpejti nis me propozimin franko-gjerman



Kryediplomati evropian Josep Borell ka paralajmëruar se në ditët e ardhshme do t'i ftojë liderët e Kosovës dhe të Serbisë për të diskutuar për propozimin franko-gjerman. Edhe kryeministri Albin Kurti ka bërë me dije se procesi i dialogut duhet të fillojë brenda disa ditëve. "Dakordimi i fundit ka një target kryesor dhe kohor për negociimin dhe pajtueshmërinë e palëve lidhur me propozimin e Bashkimit Evropian të mbështetur nga Franca dhe Gjermania", ka thënë Kurti

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 25 NËNTOR - Pas arritjes së marrëveshjes për targar ilegale serbe në mes të Kosovës dhe Serbisë më 23 nëntor, kryediplomati evropian Josep Borell ka paralajmëruar se në ditët në vijim do t'i ftojë liderët e të dyja shteteve në Bruksel për të diskutuar për "Propozimin e Brukselit" të mbështetur nga Franca dhe Gjermania.

Kryeministri Albin Kurti para deputetëve të Kuvendit ka thënë se qëllimi i qeverisë që drejton ishte që propozimi franko-gjerman për normalizim përmes një marrëveshje ligjërish të obligueshme ndërkombëtare të bëhet çështje e bisedimeve në Bruksel drejt arritjes së një dakordimi "i cili shtetit tonë, që është normal e demokratik, ia bashkëngjit edhe një raport normal e evropian me Serbinë, me fqinjën tonë veriore", ka thënë Kurti, duke shtuar se Kosova dëshiron që të krijojë një masë elementare mirëbesimi për t'i dhënë shans dialogut me

shpejtësi.

Kurti ka theksuar se procesi i dialogut duhet të fillojë brenda disa ditëve. "Dakordimi i fundit ka një target kryesor dhe kohor për negociimin dhe pajtueshmërinë e palëve lidhur me propozimin e Bashkimit Evropian të mbështetur nga Franca dhe Gjermania, e ajo është sa më shpejt, por jo më vonë sesa fillimi i pranverës së vitit 2023, që thuhet në paragrafin e parafundit. Pra para fillimit të pranverës të vitit 2023, mund të jetë më herët, por nuk bën të jetë më vonë. Dhe marrëveshja e cila duhet të arrihet duhet të jetë ligjërish e obligueshme dhe ndërkombëtarisht e obligueshme. Pra ne nuk dëshirojmë vetëm marrëveshje për normalizim të plotë që është ligjërish e obligueshme, por edhe ndërkombëtarisht e obligueshme, në frymën dhe në qëllimin e Konventës së Vjenës për Ligjin për Traktatin. Kjo e bën edhe ndërkombëtarisht përveçse ligjërish të obligueshme", ka deklaruar Kurti.

Ai ka theksuar se tash një tjetër

çështje e rëndësishme është që marrëveshja i referohet qëndrimit zyrtar të Bashkimit Evropian që produktet e dialogut të Brukselit, pra marrëveshjet e kaluara janë të nënkuptuara si një dimension i përgjithshëm i cili edhe është pjesë përbërëse e planit franko-gjerman. "Tash ne nuk mund ta mohojmë një nënkuptim të tillë të Bashkimit Evropian, por ne theksojmë se çdo gjë në lidhje me to është dhe do të konsiderohet në kuadër të propozimit të Bashkimit Evropian, të mbështetur nga Franca, Gjermania dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Pra ne kemi pranuar që marrëveshjet e Brukselit janë element i fushëveprimit të planit Franko-Gjerman në tërësinë dhe ambiguëtitin e tyre bashkërisht", ka thënë Kurti.

Më 10 nëntor, presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani-Sadriu, ka pohuar se ky propozim "shërben si bazë e mirë për diskutime të mëtejshme [në dialogun Kosovë - Serbi]".

Ndërkaq kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, në një intervistë për Klan Kosovën më 8 nëntor, ka thënë se "esenca e propozimit (franko-gjerman) është se Serbia heq dorë prej Kosovës". "[Propozimi] ndërtohet mbi tri principe. E drejta e barabartë mes shteteve, respektimi reciprok i sovranitetit dhe është e drejta e palëve për vetëvendosje", pati deklaruar Konjufca.

Ai e quajti bazë të shëndoshë këtë propozim pasi tha se nëse Serbia pajtohet që ta respektojë sovranitetin dhe të drejtën e vetëvendosjes atëherë, sipas tij,

"kjo është më e rëndësishme sesa njohja verbale [nga Serbia]". Por, Konjufca shprehu edhe rezerva sa i takon këtij propozimi pasi, mes të tjerash, tha se ai e obligon Kosovën që t'i respektojë të gjitha marrëveshjet e arritura deri më tani.

Lideri i PDK-së, Memli Krasniqi, ka thënë se kështu siç është plani franko-gjerman nuk duhet të pranohet nga askush. Krasniqi në emisionin "Pressing" në T7 ka theksuar se një draft të tillë nuk beson që ka ndonjë parti shqiptare që mund ta votojë. "Nëse ai heq dorë prej njohjes së ndërsjellë është si me heq dorë prej shtetësisë së Kosovës. Është diçka e papranueshme. Ashtu siç është sot plani franko-gjerman nuk do të pranohet nga askush. Drafti aktual i këtij që është sot nuk besoj se ka ndonjë parti shqiptare që mund ta votojë. Ai draft i është dorëzuar kryeministrit dhe presidentes", ka thënë Krasniqi.

Ekspteri për Ballkanin, Toby Vogel, thotë se mbetet për t'u parë nëse marrëveshja e targave realisht do të përkthehet në negociata, për çka shton se ka shumë hapësirë për "manipulime të mundshme". "Mendoj se interesi themelor i Serbisë është t'i vonojë sa më shumë që të mundet [negociatat] dhe nuk kam dyshim se do ta bëjë këtë", ka theksuar Vogel për "Radion Evropa e Lirë".

Vogel shton se është në fuqinë e lehtësuesit nëse dëshiron që palët të përqendrohen në marrëveshjen përfundimtare. Por, ai nuk beson që Serbia do të negocionte me mirëbesim.

"Besoj se Kosova është shumë

entuziaste për ta bërë këtë dhe Serbia jo. Dhe, tejkalimi i këtij hendeku mes palëve do të bjerë mbi lehtësuesin [kryediplomatin evropian Josep Borrell], autoriteti i të cilit mendoj se ra në masë të madhe nga ajo që ndodhi këtë javë në Bruksel", ka vlerësuar Vogel.

Portali informativ "Euractiv" publikoi më 9 nëntor një dokument, për të cilin tha se është draft i propozimit franko-gjerman. Dokumenti i publikuar përmban 9 nene.

Fillon me pajtim për marrëdhënie normale në mes të Kosovës dhe Serbisë, angazhimin për integrim në BE, zgjidhjen e mospajtimeve dhe respektimin e integritetit territorial, respektimin e subjektivitetit të njera-tjetres, respektimin e ndërsjellë të juridiksionit, zotimin për rritje të bashkëpunimit në fusha të ndryshme, përfshirë ekonomi, shkencë, gjyqësor, fushën e mbrojtjes etj. E, po ashtu, edhe shkëmbimin e misionëve të përhershme si dhe e fundit, pajtimi i palëve që kjo marrëveshje nuk ndikon në marrëveshjet e arritura më parë.

Ndërkombëtarët e përfshirë në dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë, Borrell dhe Lajçak, përveç se konfirmuan ekzistencën e planit, thanë se ai ishte propozim i tyre dhe se ishte mbështetur nga Gjermania dhe Franca në veçanti. "Kemi marrë përgjigje nga të dyja palët. Jemi duke studiuar dhe mendoj se është një shkas i mirë që duhet të shfrytëzohet për ta arritur normalizimin e raporteve ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit", kishte deklaruar më parë Josep Borrell.

UÇK-ja, rruga e nderit dhe e dinjitetit



Akademik Pëllumb XHUPI

Epopeja e shkruar me gjak në Prekaz e Llaushë më 5, 6 e 7 mars 1998 ndryshoi historinë dhe paralajmëroi lindjen e një shekulli të ri për popullin shqiptar të Kosovës e për mbarë shqiptarinë. Zhvillimet e deriatëhershme në Kosovë e kishin paralajmëruar këtë stad të ri të qëndresës së popullit shqiptar të Kosovës. Demonstratat e vitit 1968 dhe ato masive të mars-prillit 1981 ishin premisat që e vendosën Kosovën në krye të shqetësimeve ndërkombëtare dhe që përgatitën luftën çlirimtare të viteve 1998-1999.

Deri në atë çast forca politike, të lindura pas vitit 1990, e në mënyrë të veçantë LDK-ja e drejtuar nga dr. Ibrahim Rugova, kishin bërë përpjekje për ta mbajtur brenda suazës së një qëndrese pacifiste qëndresën e popullit shqiptar të Kosovës ndaj represionit të pushtuesit serb. Në fakt, kjo pati meritën se në planin politik e propagandistik i qëndroi me konsekuencë opsionit të një Kosove shtet i pavarur, edhe pse në lëmin e veprimtimit konkret iu ruajt përpjekje me pushtuesin serb duke mos konsideruar, as për së largu, format e një qëndrese të fortë e deri të armatosur.

Por, problemi ishte se rruga pacifiste nuk jepte shenjë se mund të çonte në arritjen e atij qëllimi të lartë. Politika e mospërfshirjes në konfliktet që sollën shkatërrimin e ish-Jugosllavisë nuk u shpërblye siç shumëkush shprehte. Kosova nuk u ftua në Dejton më 1995, e kur një funksionar i lartë i administratës amerikane u pyet, se përse në bisedimet e Dejtonit mun-gonin përfaqësuesit e Kosovës, përgjigjja e shkurtër e tij ishte: "Në Dejton janë ftuar ata që kanë luftuar".

Periudha pas Dejtonit mund të quhet periudha e zhgënjimit për shqip-tarët. Ndërkombëtarët, të kënaqur nga mbyllja e konfliktit në ish-Jugo-sllavi, nxituan ta njohin Jugosllavinë e Millosheviqit, ta pranojnë atë në OKB e në organizatat e tjera ndërkombëtare, dhe t'i heqin sanksionet ndaj saj, duke lënë vetëm të ashtuquajturin "mur i jashtëm i sanksioneve", me vlerë simbolike. Sa i përket Kosovës, presioni i tyre mbi Millosheviqin konsistonte në rikthimin e autonomisë të njohur nga Kushtetuta e vitit 1974, të cilën ai e kishte fshirë me një të rënë të lapsit më 1989. Pas Dejtonit, Millosheviqi u mundua ta

reduktonte problemin e shqiptarëve të Kosovës në të ashtuquajturën "Marrëveshje e Arsimit", për të cilën ishte bërë dorë-zënë Komuniteti i San Egidios, një organizatë fetare vullnetmirë, e angazhuar edhe më herët për zgjidhjen paqësore të konflikteve etnike në botë. Por, ende në marsin e vitit 1998 asnjë hap nuk ishte bërë për ta zbatuar marrëveshjen në fjalë: nxënësit e studentët shqiptarë vazhdonin t'i ndiqnin mësimet në kushte ilegaliteti, në lokale e banesa private. Për më tepër, prania e forcave të sigurisë serbe në Kosovë u shtua dhe, bashkë me to, edhe dhuna. Qasja pacifiste ishte ezauruar dhe rinia e Kosovës u orientua drejt një zgjidhjeje tjetër. Qysh në fillim të shkatërrimit të ish-Jugosllavisë, një grup të rinjsh, patriotë e idealistë nga krahina të ndryshme të Kosovës, kishin përqafuar vendosmërisht opsionin e qëndresës së armatosur kundër pushtuesit serb. Përfaqësueset politike e kësaj vije u bë LPK-ja, e cila përcaktoi si detyrë parësore krijimin e një force ushtarake në funksion të çlirimit kombëtar, Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Dalja e saj publike ndodhi në Llaushë më 28 nëntor 1997. Atë ditë, në ceremoninë për përcjelljen e mësuesit Halit Geci, rënë dëshmor gjatë një përpjekje me forcat serbe, mes mijëra e mijëra pjesëmarrësve, ra në sy prania e një grupi të rinjsh, të armatosur e me uni-formën e UÇK-së. Fjalimi i drejtuesit të tyre, komandant Rexhep Selimit, u mbyll me një betim solemn e me thirrjen për një bashkim të gjithë shqip-tarëve në luftën çlirimtare.

Lufta e UÇK-së ua prishi qetësinë ithtarëve të zgjidhjes paqësore. Në Prishtinë e në Tiranë pati nga ata që akuzuan UÇK-në si, kinse, organizatë marksiste-leniniste, madje si krijesë e UDB-së. Akuzat të tilla i erdhën për shtat Millosheviqit


e kancelarive të ndonjë vendi evropian. Madje korit kundër UÇK-së iu bashkua edhe ndonjë funksionar i administratës amerikane. Më 24 shkurt 1998, i dërguari i posaçëm për Ballkanin, ambasadori Robert Gelbart, zhgënjeu shumëkënd, kur në një deklaratë që bëri bujë, lëvdoi Millosheviqin për "hapat pozitivë" që ky paskësh bërë në zbatim të Marrëveshjes së Dejtonit, njëherësh i definoi si "terroriste" aksionet ushta-rake dhe vetë UÇK-në. Siç do të shkruante atëkohë Wolfgang Petritsch, "duke etiketuar si organizatë terroriste UÇK-në, Gelbart mbështeste indirekt kursin e ashpër të Millosheviqit". Dhe, në fakt, njeriu që nuk udhëhoq nga arsyeja njerëzore, por nga instinkti i kafshës, Slobodan Milosheviqi, i konsideroi deklaratat e Gelbartit si një leje për të vrarë. Vetëm pak ditë pas kësaj deklaratë, më 28 shkurt, kasapi i Ballkanit urdhëroi operacionin e parë të madh të njësisve speciale kundër fshatrave dhe bazave të UÇK-së në Drenicë. Me mijëra forca trupa serbe, të mbështetura nga autoblanda, artileri dhe helikopterë, u lëshuan fillimisht kundër fshatrave Likoshan e Çirez duke vrarë civilë, gra, fëmijë dhe pleq. Paskëta, më 5 mars, njësitë speciale serbe rrethuan fshatrat Prekaz dhe Llaushë. Këtu, në luftë të paba-rabartë me forcat e armikut, që zgjati tri ditë, ranë theror mbi 60 veta, ndër të cilët 22 i përkisnin familjes së ngushtë Jashari. Në krye të asaj beteje epike ishte komandanti legjendar i UÇK-së, Adem Jashari, i cili ra duke luftuar si luan, me armë në dorë. Vendosmëria e tij, e bashkëluftëtarëve, familjarëve e bashkëfshatarëve të tij për të luftuar deri në fishekun e deri në frymën e fundit kundër forcave shumë herë superiore të armikut, tron-diti opinionin shqiptar dhe

atë ndërkombëtar. Mesazhi që epopeja e përg-jakshme e Jasharëve përcolli në botë ishte tronditës: populli shqiptar dhe Ushtria e tij Çlirimtare e Kosovës e kishin marrë vendimin: lirinë e tyre, lirinë e vërtetë, ata do ta fitonin ashtu siç gjithmonë ka qenë në traditën e shqiptarit, me luftë të vendosur e pa kompromis, pa marrë parasysh vuajtjet e sakrificat që një luftë e tillë premtonte. Holokausti i Jasharëve ishte prova e gjallë se shqiptarët ishin gati për sakrificën sublime. Dhe si me magji, pas 7 marsit gjithçka ndryshoi. Më 10 mars u mbledh për herë të parë në Londër Grupi i Kontaktit për Kosovën, që i drejtoi regjimit të Beogradit paralajmërimin e parë serioz, për ta pushuar represionin dhe për t'i tërhequr trupat speciale nga territori i Kosovës. Deklaratat e pamatura të Gelbartit u harruan dhe ai vetë nuk u duk më në skenën e dramës kosovare. Vendin e tij e zunë përfaqësuesit e një politike të prerë e të vendosur ndaj kasapit të Ballkanit: "buldozeri" i diplomacisë amerikane, Richard Hollbrook, njohësi i shkëlqyer i problematikave ballkanike Chris Hill, zbuluesi e denon-cuesi i pamëshirshëm i masakrave serbe, William Wolker. Vendin e Komu-nitetit paqësor të San Egidios në krah të shqiptarëve, e posaçërisht në krahun e UÇK-së, tani e zuri, as më shumë e as më pak se organizata politiko-ushtarake më e fuqishme e botës, NATO. Agjenda e NATO-s, e BE-së dhe e ShBA-së për zgjidhjen e problemit të Kosovës, e la mënjanë "Marrëveshjen e Arsimit" të ofruar nga Millosheviqi dhe vuri në rend të parë opsionin e Kosovës shtet i pavarur, që ishte opsioni i vetëm i mbarë popullit shqiptar. Kjo, pra, ishte përmbysja e jashtëzakonshme, që vuri në rrugën e zgjidhjes çështjen e Kosovës dhe që i detyrohet në vetë

të parë Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, luftës heroike të saj dhe sakrificës sublime që bënë në emër të lirisë bijtë dhe bijat më të mirë të popullit të Kosovës.

Populli shqiptar e ka vlerësuar përherë rrugën e vërtetë, të nderit e të dinjitetit. Historia jonë është e mbushur me shembuj burrash dhe grash të vërtetshëm, të ndershëm e plot dinjitet që i janë gjendur atdheut në rrezik e kështu janë bërë pjesë e ndërgjegjes sonë kombëtare. I pari ndër ta, Gjergj Kastrioti Skënderbeu, është objekt i krenarisë dhe i adhurimit pashqiptar. Por, historia jonë sa e vjetër, aq edhe e re, ka treguar se, kur vjen çasti i provës së madhe, siç ishte ai i viteve 1998-1999, nuk mungojnë edhe ata shqiptarë që në kohë paqeje përgjërohen për Gjergj Kastriotin, por në kohë lufte sillen si Hamza Kastrioti. Prandaj, ne bëjmë mirë që heronjtë tanë, ata të vërtetët, siç janë djemtë e vajzat, burrat dhe gratë e UÇK-së, të rënë theror për lirinë e atdheut në altarin e lirisë, t'i kujtojmë përherë me mirë-njohje, siç po bëjmë sot, t'i derdhim në bronz, t'i gdhendim në gur e, mbi të gjitha, t'i shkruajmë në libra, që fëmijët tanë të mësojnë se cila është rruga e vërtetë e vërtetë, e nderit dhe e dinjitetit.

(Marrë nga libri "Ushtria Çlirimtare e Kosovës, vlerë kombëtare", botuar nga Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës. Kjo kumtesë është paraqitur në sesionin shkencor mbajtur në Prishtinë më 7 mars 2022, organizuar nga: Instituti Albanologjik i Prishtinës, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave e Shqipërisë dhe Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës. Kumtesat e njëzet intelektualëve shqiptarë gazeta "Epoka e re", përpos në portal, do t'i botojë për njëzet ditë me radhë edhe në formatin pdf. Librin mund ta gjeni në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës.)



Kurti udhëton për në Spanjë

PRISHTINË, 25 NËNTOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka udhëtuar për në Spanjë. Zyra për medie e kryeministrit ka bërë me dije se Kurti merr pjesë në Kongresin e Internacionales Socialiste që mbahet në Madrid. Spanja është një ndër pesë

vendet e Bashkimit Evropian që nuk e njeh shtetin e Kosovës. Madje, siç raportohet, Spanja ka kërkuar që çështja e liberalizimit të vizave për Kosovën, saktësisht hyrja në fuqi, të jetë më 1 janar 2014 e jo më 1 dhjetor të vitit 2023 siç ishte propozuar. Një kërkesë e tillë e Spanjës

kishte ardhur me arsyetimin se çështja e liberalizimit të vizave nuk dëshiron të jetë në agjendë në kohën sa Presidencën e BE-së e udhëheq Spanja, vend ky që nuk e sheh shtetësinë e Kosovës. Spanja do të udhëheqë Presidencën e BE-së nga 1 korriku deri më 31 dhjetor 2023.



Kuvendi i Kosovës për herë të parë përfaqësohet në Komitetin e Përhershëm të APKE-së

PRISHTINË, 25 NËNTOR - Komiteti i Përhershëm i Asamblesës Parlamentare të Këshillit të Evropës (APKE) të premtën në Reykjavik të Islandës ka mbledhur rreth 60 anëtarë, në të cilin po merr pjesë edhe anëtari i delegacionit të Kosovës, Arben Gashi. Kjo pjesëmarrje shënon herën e parë që delegacioni i Kuvendit të Kosovës përfaqësohet në një takim të këtij niveli që kur ka filluar të marrë pjesë në aktivitetet e kësaj organizate.

Takimin e ka hapur presidenti i APKE-së, Tiny Kox, duke pasuar me një fjalim mirëseardhjeje nga Alþingi Birgir Armannsson, kryetar i Parlamentit të Islandës. Po ashtu, pjesëmarrësve u është drejtuar edhe Bordis Kolbrun Reykþjoro Gylfadottir, ministre e Punëve të Jashtme dhe kryesuese e Komitetit të Ministrave.

Islanda ka marrë kryesimin e kësaj organizate që nga ky muaj dhe do ta mbajë deri në maj të vitit të ardhshëm.

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave do të organizohet një aktivitet mbi "Dhunën Digjitale ndaj Grave".

Parlamentarët, gjithashtu, do të zhvillojnë një debat për çështjet aktuale mbi "Përshkallëzimin në luftën e agresionit të Federatës Ruse kundër Ukrainës". Ata pritet që të miratojnë një deklaratë për Samitin e 4-të të krerëve të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës i cili do të mbahet në Reykjavik më 16-17 maj 2023.

Gjatë këtij takimi do të diskutohet edhe për rolin e



Këshillit të Evropës si një gur themeli i arkitekturës politike evropiane, mbrojtjen e demokracisë gjatë krizave shëndetësore, ndikimin e pandemisë Covid-19 në hapësirën e shoqërisë civile dhe

mbi popullimin e burgjeve - ofrimin e sigurt të kujdesit shëndetësor, vlerësimin e partneritetit për demokraci në lidhje me Parlamentin e Jordanisë si dhe raportet rreth vëzhgimit të zgjedhjeve të

parakohshme parlamentare në Bosnjë-Hercegovinë dhe Bullgari. Komiteti i Përhershëm i APKE-së përbëhet nga presidenti dhe nënkryetarët e APKE-së, kryetarët e grupeve politike, kryesuesit e delegacioneve

kombëtare dhe kryetarët e komiteteve, me rreth 60 parlamentarë nga 46 shtete anëtare të Këshillit të Evropës, si dhe nga Kosova, e cila tashmë ka aplikuar për anëtarësim të plotë në këtë organizatë.

Nis subvencionimi i faturave të energjisë elektrike


PRISHTINË, 25 NËNTOR - Qeveria e Kosovës ka bërë me dije se ka nisur subvencionimi i faturave të energjisë elektrike të konsumatorëve.

Ministri i Financave dhe Transfereve, Hekuran Murati, ka bërë me dije se tashmë është procesuar dhe reflektuar në llogaritë e konsumatorëve pagesa e subvencionit për faturën e muajit shtator të energjisë elektrike për të gjithë ata që kanë kursyer sipas kushteve të masës mbështetëse.

"Të gjithë përfituesit vlerën e subvencionit mund ta shohin të reflektuar edhe në llogarinë online me furnizuesin. Secili konsumator aktiv (fatura mbi 5 euro), që ka kursyer sasinë e kWh me së paku 5 për qind krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak, përfiton subvencionim të faturës aq sa dyfishi i përqindjes së kursimit", ka shkruar ai në rrjetet sociale.

Ministri ka deklaruar se maksimumi i subvencionit për një muaj është vlera e faturës së

muajit përkatës, apo taveni 50 euro, cilado të jetë më e ulët. "Nëse në shtator 2021 keni shpenzuar 1,000 kWh, ndërsa në shtator 2022 keni shpenzuar 800 kWh, i bie që keni kursyer 20 për qind të energjisë elektrike. Subvencioni llogaritet duke dyfishuar përqindjen e kursimit, pra $2 \times 20\% = 40\%$ dhe aplikohet në vlerën e faturës së muajit aktual. Pra nëse fatura e shtatorit është 40 euro, për shkak se keni kursyer, ju përfitoni subvencion 40% x 40 euro, apo 16 euro", ka



shkruar Murati. Për muajin shtator bëhet me dije se kriterin për subvencion e

kanë përmbushur 167 571 konsumatorë rezidencialë të energjisë elektrike.

Më 25 dhjetor, zgjedhjet për kuvendet komunale në Zveçan dhe Leposaviq

PRISHTINË, 25 NËNTOR - Presidentja Vjosa Osmani ka caktuar 25 dhjetorin datë për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin Komunal të Zveçanit dhe atë të Leposaviqit.

Pas vendimit të Qeverisë së Kosovës për shpërndarjen e kuvendeve komunale në Zveçan dhe Leposaviq, pas konsultimit me partitë politike dhe duke pasur

parasysh që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të ketë kohë të mjaftueshme për organizimin dhe mbarëvajtjen e zgjedhjeve, presidentja Osmani, në përputhje me afatet dhe detyrimet ligjore, caktoi 25 dhjetorin datë të zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin Komunal të Zveçanit dhe atë të Leposaviqit.

Ajo i ka ftuar subjektet politike për fushatë të qetë, pa tensione, duke respektuar kodin elektoral dhe rivalët politikë.

Zgjedhjet për Kuvendin Komunal të Zveçanit dhe atë të Leposaviqit do të mbahen pas dorëheqjes së anëtarëve të kuvendeve komunale dhe shpërndarjes së tyre më 18 nëntor nga Qeveria e Republikës së Kosovës.



70-vjeçari në Prishtinë vret me sëpatë gruan 63-vjeçare



Me urdhër të prokurorit të shtetit është ndaluar një burrë 70-vjeçar nën dyshimin se vrau me sëpatë gruan e tij 63-vjeçare në shtëpinë e tyre në Prishtinë. Ngjarja ka ndodhur mëngjesin e së premtes, ku rreth orës 04:40 i dyshuari është paraqitur në Stacionin Policor Qendra në Prishtinë. Aktualisht nuk dihet motivi i kryerjes së këtij akti

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

Prishtinë, 25 nëntor - Një 70-vjeçar ka vrarë me sëpatë gruan e tij 63-vjeçare në Prishtinë. Prokuroria Themelore e Prishtinës ka dhënë detaje për vrasjen që ka ndodhur të premten në Prishtinë. "Prokurori kujdestar nga Departamenti i Krimeve të

Rënda, bashkë me njësitë relevante, kanë dalë në vendin e ngjarjes, me ç'rast kanë ndërmarrë veprimet hetimore si dhe në vendin e ngjarjes është sekuestruar sëpata me të cilën dyshohet se është kryer vepra penale, ndërsa me urdhër të prokurorit është dërguar për obduksion trupi i pajetë", është thënë në njoftimin e Prokurorisë.

Ngjarja ka ndodhur mëngjesin e së premtes, ku rreth orës 04:40 i dyshuari është paraqitur në Stacionin Policor Qendra në Prishtinë.

Aktualisht nuk dihet motivi i kryerjes së këtij akti.

Ngjarja ka ndodhur në ditën kur ka nisur fushata "16 ditët e Aktivizmit Kundër Dhunës me Baza Gjinore" organizuar nga

Ministria e Drejtësisë.

Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) ka shprehur shqetësimin e thellë në lidhje me vrasjen e sotme të një gruaje 63-vjeçare nga bashkëshorti 70-vjeçar. "Në vazhden e lajmeve të përditshme për ngacmime seksuale, dhunë me bazë gjinore dhe përdhunime të vajzave, si dhe në ditën kur fillon fushata botërore '16 Ditët e

Aktivizmit kundër dhunës ndaj grave', vrasja e 63-vjeçares në Prishtinë vetëm se shpërfaq dhe thekson pasojat e rrënjësura të normave patriarkale dhe kulturore në kuadër të të cilave gratë vriten vetëm pse janë gra! Gratë po jetojnë në ambiente kërcënuese në Kosovë! Masat rehabilituese për abuzues ende nuk ekzistojnë dhe viktimat e dhunës me bazë gjinore vazhdojnë të mbesin pa rrugëdalje nga dhuna e përsëritur", është thënë në reagimin e RrGK-së, duke theksuar se punësimi i grave dhe trashëgimi i pronës mbesin ndër më të ulëta në Ballkan dhe kjo i mban gratë të lidhura në ambiente abuzuese. "Vlerësimet e rrezikshmërisë nga ana e zyrtarëve policorë janë të dobëta dhe pasojnë me raste recidiviste. Dënimet nga gjykatat vazhdojnë të jenë të ulëta dhe absurde duke rikthyer në gjykim personat përgjegjës për vrasje brutale të grave dhe duke u dhënë të njëjtëve rrethana lehtësuese përgjatë procedurës penale. Kjo hallkë e rrethanave na tregon se vrasja e grave vjen si pasojë e dështimit institucional, social e kolektiv, në trajtimin e dhunës me bazë gjinore si çështje parësore, në kuadër të sundimit të ligjit dhe qasjes në drejtësi. Andaj, RrGK kërkon që të shqiptohet masa ndëshkuese maksimale dhe të mos merren në konsideratë si masa lehtësuese dorëzimi i tij në polici dhe mosha e dhunuesit, siç është praktikë të konsiderohen këto të fundit nga gjykatat", është thënë në reagimin e RrGK-së.

Më 27 nëntor mbahet mbledhja e përbashkët e Kuvendit të Kosovës dhe Kuvendit të Shqipërisë

PRISHTINË, 25 NËNTOR - Në shënim të 110-vjetorit të Pavarësisë Shqipërisë, të dielën, më 27 nëntor 2022, në orën 10:00, në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë në Tiranë, do të mbahet mbledhje e përbashkët e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Në këtë mbledhje deputetëve do t'u paraqiten kryetarja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Lindita Nikolla dhe kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Glauk Konjufca. Mbledhja do të vijojë me fjalimin e kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, Edi Rama dhe fjalimin e

kryeministrit të Republikës së Kosovës, Albin Kurti. Nga një fjalë përshëndetëse do ta mbajnë edhe kryetarët e grupeve parlamentare të Kuvendit të Shqipërisë dhe Kuvendit të Kosovës.

Në shënim të këtij përvjetori do të mbahen edhe aktivitete të tjera kulturore.



Kuvendi i Shqipërisë miraton projektin për portin e Durrësit

TIRANË, 25 NËNTOR - Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar marrëveshjen për realizimin e projektit "Durrës Yachts & Marina" që, sipas qeverisë, do të jetë porti më i madh turistik i Mesdheut. Në seancën e së enjtes, e cila zgjati rreth 14 orë, pas mesnate u miratua marrëveshja e nënshkruar ndërmjet qeverisë shqiptare dhe investitorit nga Dubai, Mohamed Alaabar.

Në favor të kësaj marrëveshjeje votuan 76 deputetë, ndërsa 35 deputetë votuan kundër këtij projekti.

Kuvendi i Shqipërisë ka 140 deputetë, ndërsa në momentin e votimit të pranishëm në sallë ishin 111 deputetë.

Kryeministri Edi Rama nuk ishte i pranishëm në momentin e votimit.

Seanca u shoqërua me debate të ashpra dhe u ndërpre dy herë për shkak të tensioneve të krijuara gjatë fjalës së kreut të Partisë Demokratike, Sali Berisha.

Rama, gjatë fjalës së tij në Kuvend, e mbrojti projektin, duke e cilësuar historik.



"Investimi kap vlerën e 1.2 miliard eurove. Do të jetë një motor i jashtëzakonshëm ekonomik për Durrësin e mbarë Shqipërinë", tha Rama duke iu përgjigjur kritikave dhe akuzave të opozitës për marrëveshjen.

Opozita e konsideron projektin e Portit të Durrësit si një nga aferat më të mëdha të qeverisë

Rama. "Marrëveshja shkel me të dyja këmbët Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit, shkel Kushtetutën e Shqipërisë. Marrëveshja është një mashtrim fund e krye ligjor", tha Berisha.

Shefi i grupit parlamentar i PD-së, Enkelejd Alibeaj, tha se në Portin e Durrësit do të pastrohen

paratë e kirit.

Marrëveshja për realizimin e projektit "Durrës Yachts & Marina" u nënshkrua më 11 gusht të këtij viti ndërmjet qeverisë shqiptare dhe investitorit arab Muhammed El Alabbar. Disa ditë pas nënshkrimit, pati një reagim nga zyra e delegacionit të Bashkimit

Evropian në Tiranë, duke kërkuar më shumë transparencë dhe qartësi.

Më 23 nëntor Zyra e BE-së në Tiranë njoftoi se është anuluar granti i Fondit të Investimeve për Ballkanin Perëndimor për portin e Durrësi për shkak të modifikimit të projektit.

Vlera e këtij granti ishte 28 milionë euro.

Por, të enjten gjatë fjalës së saj para deputetëve, zëvendëskryeministrja Belinda Balluku tha se anulimi i grantit ishte kërkuar prej saj në vitin 2019.

Pas miratimit në Kuvend, marrëveshja shkon në Presidencë për dekretim.

PD-ja ka depozituar padi në Gjykatë Kushtetuese dhe ka informuar partnerët ndërkombëtarë pasi pretendon se projekti shkel Marrëveshjen e Asociim- Stabilizimit. Me nisjen e zbatimit të marrëveshjes me investitorin arab në Durrës, porti tregtar do të duhet të zhvendoset në Porto Romano. Sipas Ballukut, ky port i ri nuk do t'u përgjigjet vetëm nevojave të Shqipërisë, por edhe të Kosovës.

Mbahet punëtorja për auditim në nivelin e pushtetit lokal

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 25 NËNTOR - Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) dhe Misioni në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE)/Departamenti për Demokratizim kanë mbajtur punëtorinë për përmirësimin e zbatimit të rekomandimeve të auditimit në nivelin e pushtetit lokal.

Punëtorja është mbajtur në rajonin e Gjilanit, Prizrenit dhe Prishtinës në të cilën janë përfshirë të gjitha komunat e Kosovës me datë 15, 17 dhe 22 nëntor.

Zyra Kombëtare e Auditimit në këtë punëtori ka qenë e përfaqësuar nga ndihmësauditatori i përgjithshëm Zukë Zuka, drejtoresha e Departamentit për Auditimin e Komunave, Shehrije Shala, dhe udhëheqësi i ekipit të auditimit, Florim Beqiri. Ndërsa nga Departamenti për Demokratizim i OSBE-së ka marrë pjesë Fatmir Zylfijaj nga



Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Fetije Begolli, si dhe kryesues të kuvendeve komunale, zyrtarë kryesorë financiarë, auditorë të brendshëm dhe drejtorë financiarë.

Punëtorja kishte për qëllim të shërbejë si platformë diskutimi për sfidat kryesore në zbatimin e rekomandimeve dhe planeve të veprimit si dhe rolin e legjislacionit komunal në çështjet financiare, raportimin rreth auditimit dhe transparencës.

Kjo punëtori ishte një mundësi e mirë që përfaqësuesit komunalë diskutojnë me përfaqësuesit e ZKA-së dhe të

MAPL-së rreth gjetjeve kryesore të raporteve të auditimit për vitin 2021, sfidat kryesore të identifikuar, përfitimet që vijnë nga rritja e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të auditimit, si dhe për rolin e legjislacionit komunal dhe grantit të performancës për komunat.

Me këtë rast përfaqësuesit e ZKA-së kanë ofruar pikëpamjet e tyre për sa iu përket veprimeve të duhura që do të ndikonin në përmirësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit në komuna. Fokus i veçantë i është dhënë zbatimit sa më efikas të rekomandimeve të auditimit dhe shkëmbimit të përvojave ndërmjet komunave.

Rita Ora në pullën postare të Kosovës



PRISHTINË, 25 NËNTOR - Këngëtarja me prejardhje shqiptare, Rita Ora, tashme është pjesë e thesarit të pullave postare të Filatelistë së Postës së Kosovës.


Pulla me imazhin e saj do të lëshohet në qarkullim postar të shtunën, më 26 nëntor, në një ditë të veçantë për artisten e madhe shqiptare dhe britanike, pikërisht në ditëlindjen e saj, shkruan Posta e Kosovës.

Kryeshefja ekzekutive e Postës së Kosovës, Fakete

Kadiu, ka shprehur mirënjohje për yllin e muzikës. "Është një nder për Postën e Kosovës ta nderoj Rita Orën. Ajo na ka dhuruar aq shumë momente të bukura dhe krenari të pafund me këngë, performancë dhe koncerte madhështore. Kjo pullë e bukur le të jetë edhe si dhuratë simbolike e Kosovës për këngëtarën tonë, në këtë ditë të veçantë për të, për kontribut të jashtëzakonshëm për vendin dhe kombin tonë", ka thënë Kadiu.



Si ta përdorim teknologjinë pa e shkatërruar jetën tonë



Nga Arthur C. BROOKS

Në vitin 1995, shumë vite përpara se të fillonte të bashkëpunonte në kërkimet e mia për këtë rubrikë, Rena Rudavski dhe familja e saj u zgjodhën për të marrë pjesë në një eksperiment teknologjik inovativ. Studiuesit nga Universiteti "Carnegie Mellon", instaluan një kompjuter në dhomën e tyre të ngrënies duke e lidhur me internetin.

Në atë kohë, vetëm 9 për qind e amerikanëve përdornin internetin (në vitin 2020 kjo normë ishte gati 91 për qind). Rena, që në atë kohë ishte në vitet e para të shkollës së mesme, kujton se ulej çdo ditë para kompjuterit, bisedonte në "chat rom" dhe shfletonte faqe të ndryshme në internet.

Kur eksperimenti mbaroi, vendin e tyre e zuri një familjar. Çuditërisht, ky eksperiment nuk shkaktoi shumë diskutime në shtëpi. "Ne nuk flisnim shumë në dhomën e ngrënies kur kompjuteri ishte ndezur. Për më tepër asnjëri prej nesh nuk i ndau përvojat vetjake në internet me anëtarët e tjerë të familjes"- më shkroi Rena me e-mail.

Përvoja e Renës ishte e zakonshme, siç tregohet edhe nga studiuesit që publikuan studimin HomeNet në vitin 1998, që sot është bërë i famshëm. "Rritja e përdorimit të internetit, shoqërohet me një rënie të komunikimit të pjesëmarrësve me familjet e tyre dhe në një reduktim të madhësisë së rrethit të tyre shoqëror"- shkruan studiuesit.

Ajo çfarë ishte edhe më shqetësuese, ishte se kjo çoi në "një rritjen e depresionit dhe vetmisë tek pjesëmarrësit". Rena

thotë se përvoja e saj i vërteton këto rezultate. Studimi HomeNet mund të interpretohet (dhe është interpretuar në fakt) si një aktakuzë kundër internetit, ekraneve apo teknologjisë moderne të komunikimit në përgjithësi.

Ai ilustron një të vërtetë shumë më të thjeshtë në lidhje me dashurinë dhe lumturinë: teknologjia që përjashton ndërveprimin me të tjerët në jetën reale e zvogëlon mirëqenien tonë, ndaj duhet të trajtohet me shumë kujdes në jetën tonë. Për të korrur përfitimet e plota, ne duhet të përdorim mjetet dixhitale në mënyra që i përmirësojnë marrëdhëniet tona sociale.

Pandemia e Covid-19 krijoi një mjedis pjellor për kërkimin e lidhjeve sociale. Sa herë që rrethanat e jetës sociale ndryshojnë papritur, studiues si unë nxitojnë që t'u bëjnë njerëzve pyetje të bezdisshme. Një nga fushat më të zakonshme të analizës gjatë 2 viteve të fundit ka qenë përpjekja për të kuptuar se si zhvendosja jonë e papritur masive drejt komunikimit dixhital – duke pasur më pak takime personale – ka ndikuar mbi lidhjet sociale në tërësi.

Në një artikull të botuar në revistën "New Media & Society", studiuesit raportuan mbi një studim të kryer mbi 3.000 të rritur gjatë muajve të parë të pandemisë, i cili zbuloi se e-maillet, rrjetet sociale, lojërat në internet dhe mesazhet nuk ishin zëvendësuesit e duhur për ndërveprimet personale.

Thirrjet zanore dhe video-telefonat ishin pak më të mira (edhe pse kërkimet e mëvonshme e kanë vënë në dyshim vlerën e

këtyre teknologjive). Të qenit i lidhur shoqërisht është një nga çelësat e lumturisë në jetë. Nëse zvogëlohen këto lidhje, ju do të jeni më keq, dhe e njëjta gjë do të ndodhë edhe me të familjarët tuaj, veçanërisht me fëmijët tuaj.

Një studim i vitit 2014 zbuloi se 62 për qind e fëmijëve amerikanë besojnë se prindërit e tyre janë shumë të hutuar për t'i dëgjuar. Arsyeja kryesore është përdorimi i tepruar i telefonit nga prindërit. Mënyra sesi lundrimi në internet i redukton lidhjet sociale është e qartë: ato janë aktivitete që i zëvendësojnë ndërveprimin sociale.

Por komunikimet virtuale, si mesazhet me tekst, janë në thelb ndërvepruese, dhe në teori duhet të jenë më pak të dëmshme. Por problemi është se me këto teknologji ne e humbasim thellësinë e raporteve sociale. Mesazhet me tekst nuk mund të përcjellin shumë mirë emocionet, pasi ne nuk mund t'i dëgjojmë apo shohim bashkëbiseduesit tanë.

E njëjta gjë vlen edhe për mesazhet direkte në rrjetet sociale (në përgjithësi rrjetet sociale nuk përdoren për të komunikuar me një individ të vetëm, por për të transmetuar informacion tek një audiencë më të gjerë). Këto teknologji kanë të bëjnë me ndërveprimet personale: ato janë të identifikueshme, por të paafta për të prodhuar të njëjtat efekte emocionale.

Në kushtet kur komunikimet kanë dimensione të ulëta, ne priremi të kalojmë nga një person te tjetri, dhe kështu e ngatërrojmë thellësinë me gjerësinë. Kjo është arsyeja pse në bisedat ballë për ballë, ato priren të jenë më të shtrira dhe më të pasura se ato që

kryhen përmes tekstit.

Studimet kanë treguar se bisedat e thella sjellin më shumë mirëqenie psikologjike sesa komunikimet e shkurtra. Ndërkohë, një studim i kohëve të fundit zbuloi se adoleshentët që dërgonin më shumë mesazhe sesa bashkëmoshatarët e tyre, prireshin të përjetonin më shumë depresion, më shumë ankth, më shumë agresivitet dhe marrëdhënie më të këqija me baballarët e tyre.

Mund të duket e çuditshme që edhe jashtë rrethanave të imponuara nga pandemia, ne adoptojmë vullnetarisht teknologji që e dëmtojnë lumturinë tonë. Kjo ka 2 shpjegime kryesore: rehati dhe mirësjellje. Qëndrimi para një ekrani është më i lehtë sesa të flasësh me një person, dhe komunikimi virtual përmes aplikacioneve me tekst është më i shpejtë dhe më i lehtë sesa një takim personal apo një telefonatë. Zgjidhja nuk është heqja dorë nga interneti dhe as eliminimi i komunikimeve virtuale. Pasi do të rrezikonit të izoloheshit dhe ta komprometoni aftësinë tuaj për të fituar jetesën. Por hulumtimet tregojnë që ne mund të mësojmë ta përdorim teknologjitë për të plotësuar, dhe jo zëvendësuar marrëdhëniet sociale.

Kjo mund të bëhet në 2 mënyra. Në këtë parim nuk ka asgjë revolucionare: 45 vjet më parë prindërit e mi më shihnin të dilja me miqtë e mi në vend se të rrija në shtëpi dhe të shikoja televizor. Sot e dimë që nëse teprohet, shpërqendrimi në ekran e redukton lumturinë dhe mund të çojë në çrregullime të humorit si p.sh depression dhe ankth.

Që t'i braktisni zakonet problematike, mund të përdorni aplikacionet që e llogarisin kohën e kaluar në rrjetet sociale dhe në internet dhe ta kufizoni në vetëm 1 orë në ditë ose më pak. Një tjetër qasje popullore, e cila nuk është testuar ende nga kërkimet akademike, është ndryshimi i cilësimeve të pajisjes nga me ngjyrë në një ekran gri.

Djali im e ka bërë këtë dhe betohet se ka reduktuar shumë kohën që shpenzon duke lundruar në internet. Është e paarsyeshme të presësh që dikush të ndalojë së dërguari mesazhe. Por ju mund të përdorni më pak nga ky mjet komunikimi nëse keni një "listë" për të folur me miqtë, kolegët dhe njerëzit e dashur.

Kur është e mundur, takimi personal duhet të jetë i privilegjuar, veçanërisht me miqtë e ngushtë. Një studim i vitit 2021, i botuar në revistën Computers in Human Behavior Reports, zbuloi se sa më shumë njerëzit të komunikojnë ballë për ballë me partnerët e tyre, aq më shumë ndihen të kuptuar dhe aq më të kënaqur janë me marrëdhënien e tyre.

Kur është e pamundur të takoheni, zgjidhni një teknologji që përfshin kontaktin ballë për ballë ose telefonin. Përdorni komunikimin me tekst për çështje jo-personale ose urgente.

Për shumicën prej nesh – sidomos njerëzit që janë rritur me të – interneti është një pjesë e padiskutueshme e ekosistemit të jetës. Ne nuk do të kthehemi në jetën që kemi jetuar më parë me këtë lloj teknologjie. Por mund dhe duhet ta përdorim atë me kujdes në shërbim të dashurisë. / "The Atlantic" – Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

QENDRA SPORTIVE 'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Anglia ndalet nga Amerika, Holanda dhe Ekuadori ndajnë pikët



Amerika dhe Anglia nuk shkuan më shumë se një barazim pa gola. Tre Luanët kishin një ndryshim total nga pjesa e parë, duke u vendosur shpesh herë në rrezik. Në minutën e 26-të, McKennie do të humbiste një mundësi të artë brenda zonës, por goditja e tij do të përfundonte jashtë kuadrantit. Pak

minuta më pas, Pulisic do të ndalej vetëm nga traversa, pas një goditje të fortë me të majtën në hyrje të zonës. Pjesa e dytë ishte e bllokuar me pak rate shënimi në të dyja portat. Amerika humbi disi freskinë e pjesës së parë, ndërkohë që Anglia u zgjua vetëm në fundin e ndeshjes për të dhënë sinjale për golin. Harry Kane goditi me kokë brenda

zonës në shtesë, por goditja e tij shkoi jashtë kuadrantit. Pas këtij barazimi, Anglia kryeson me 4 pikë, 1 më shumë se Irani dhe dy më shumë se Amerika. Holanda nuk ka mundur të fitojë ndaj një Ekuadori tepër të fortë. Në minutën e 6-të, Gapko ishte ai që zhbllkoi sfidën pas një aksioni dhe finalizimi tepër të

bukur. Por, Ekuadori nuk ishte një ekip i lehtë, pasi ka tentuar shumë herë portën e tulipanëve të cilët e kanë ndjerë veten tepër në rrezik. Pjesa e dytë nisi në favor të Ekuadorit, pasi tentativat e shumta u kthyen në një kundërsulm të frikshëm dhe Valencia finalizoi me sukses duke barazuar kështu

rezultatit. Ekuador ka vendosur në vështirësi Holandën pothuajse gjithë ndeshjen, por goli nuk u gjet. Kështu, dy skuadrat kanë ndarë nga një pikë në këtë sfidë, duke regjistruar nga katër pikë në total, por vendi i parë do të vendoset përfundimisht në ndeshjen e radhës.

FFK-ja ankohet në FIFA për veprimin agresiv të Serbisë në Botëror



PRISHTINË, 25 NËNTOR - Federata e Futbollit e Kosovës ka njoftuar opinionin se sot ka paraqitur ankesë në FIFA për veprimin agresiv të ekipit kombëtar të Serbisë i cili në ndeshjen kundër Brazilit, në kuadër të Kupës së Botës "Katar 2022", ka vazhduar retorikën shoviniste ndaj Republikës së Kosovës. Para kësaj ndeshjeje në zhveshtoren e kombëtares së Serbisë është vendosur një flamur, ku shihej harta e Kosovës me ngjyrat e flamurit serb, me mbishkrimin "Nuk ka dorëzim". "Akte të tilla shoviniste nuk kanë vend në një ngjarje sportive, aq më pak brenda objekteve ku zhvillohet ngjarja më e madhe e futbollit botëror,

prandaj FFK si anëtare e barabartë me të gjitha anëtarët e tjera të FIFA-s, kërkon nga ky institucion që të ndërmarë masa sanksionuese ndaj veprimeve që nxisin urrejtje mes popujve dhe janë kundër vlerave njerëzore. Futbollit si sporti më i popullarizuar në botë përçon vlera bashkimi dhe assesi përçarjeje, ndërsa ky akt agresiv nuk përkon me vlerat e tilla, prandaj edhe duhet të ndëshkohet", thuhet në reagimin e FFK-së. FFK-ja konsideron se derisa Evropa e bota po ballafaqohen me një krizë të madhe si pasojë e agresionit të paprovokuar të Rusisë në Ukrainë, një kompeticion kaq madhështor siç

është Kampionati Botëror duhet të jetë vend i mbizotërimit të thirrjeve për paqe e jo të përdoret për të nxitur urrejtje mes popujve. Kosova është shtet i pavarur dhe demokratik, me respektim maksimal të të drejtave të njeriut dhe i pranuar nga shtetet më të fuqishme botërore dhe, si e tillë, do ta vazhdojë rrugëtimin e saj pa marrë parasysh provokimet si ky i fundit. "Është e papranueshme që ky akt të kalojë në heshtje, prandaj kërkojmë fuqishëm që FIFA t'i zbatojë në përpikëri rregullat e saj dhe ta ndëshkojë Federatën e Futbollit të Serbisë për këtë veprim agresiv dhe kundër vlerave që i përçon futbollit", thuhet në reagimin e FFK-së.

Prishtina do të debutojë në Ligën ENBL

PRISHTINË, 25 NËNTOR - Skuadra më e trofeshme e Kosovës në garat vendore dhe ndërkombëtare, Sigal Prishtina, do të debutojë gjatë fundjavës në Ligën ENBL. "Bardhekaltrit" janë në Grupin A së bashku me Polski Cukier, TalTech/Optibet, Budivelnik, Kalev/Cramo, Zielona Gora dhe Siauliai. Prishtinasit do të zhvillojnë dy ndeshje, të shtunën dhe të

dielën, në Tallinn të Estonisë. Të shtunën nga ora 17:00 do të ndeshen me Budivelnik nga Ukraina që garon në Ligën Ballkanike, ku kishte pësuar nga Peja dhe fitoi ndaj Bashkimit. Sfida e dytë të dielën nga ora 16:00 kundër Kalev/Cramo, ku "bardhekaltrit" ishin përballur ndaj kësaj skuadre në kualifikimet e FIBA Europe

Cup, duke pësuar 98:61. ENBL është themeluar në verën e vitit 2021 për klubet profesioniste të meshkujve nga Evropa Veriore, Qendrore dhe Lindore. Është krijuar për klubet që dëshirojnë të konkurrojnë ndërkombëtarisht në një nivel të lartë. Edicioni i parë përfshin skuadra nga Polonia, Ukraina, Republika Çeke, Lituania, Letonia, Estonia, Bjellorusia etj.



Kloppi e dëshiron Ronaldon në 'Anfield'

LIVERPOOL, 25 NËNTOR - Ka informacione se Cristiano Ronaldo mund të kalojë te Liverpooli. Thashethemet më të çmendura të ditës erdhën nga "Diario AS" mjaft i besueshëm. Botimi spanjoll pretendon se

Jurgen Klopp është i interesuar ta sjellë 37-vjeçarin në "Anfield". Manchester Unitedi dhe Ronaldo kanë shkëputur kontratën "me marrëveshje të përbashkët", që do të thotë se në janar ai mund të

transferohet pa pagesë në çdo ekip tjetër. Kjo erdhi pas intervistës së tij shpërthyes me Piers Morgan, në të cilën ai kritikoi klubin, lojtarët e rinj, ish-shokët e skuadrës dhe trajnerin. Megjithatë, është e

vështirë të besosh në një informacion të tillë. Ronaldo nuk është aspak si lloji i lojtarit që Liverpooli do të kërkonte duke pasur parasysh moshën, egon, pagën dhe një sërë faktorësh të tjerë.



Të dielën zhvillohet derbi Trepça - Peja

MITROVICË, 25 NËNTOR - Në fundjavë do të zhvillohet xhiroja e 12-të në Prince Caffè Superligë. Takimi i parë, por shumë i rëndësishëm, do të zhvillohet ndërmjet Ponte Prizrenit dhe Rahovecit. Prizrenasit kanë pesë fitore e pesë humbje, kurse Vreshtarët dy fitore e nëntë humbje, andaj ky duel është shumë i vlefshëm për të dyja skuadrat. Vëllaznimi do të përballet me Golden Eagle Yllin. Kuqezinjtë pas fitores ndaj Pejës janë të motivuar për një ndeshje tjetër të madhe, ndërsa ndeshen me Yllin, që hyn me pesë fitore



radhazi në elitë pas katër humbjeve radhazi, ndërsa skuadra nga Gjakova ka pesë fitore e gjashtë humbje. Derbi i kësaj xhiroje do të zhvillohet në mes të Trepçës dhe Pejës. Mitrovicasit hyjnë në këtë takim pas dy humbjeve radhazi, ashtu si edhe pejanët që kishin tetë fitore radhazi, prandaj është një ndeshje shumë e rëndësishme për të dyja skuadrat. "Xehetarët" kanë

gjashtë fitore e pesë humbje, kurse "verdhezinjtë" tetë fitore e dy humbje. Të dy skuadrat kanë ambicie të mëdha në këtë edicion, andaj do të jetë një super duel në "Minatori" të dielën. Duelin e parë të këtij edicioni e kishin fituar pejanët 83:72. Për shkak të paraqitjeve të prishtinasve në gara ndërkombëtare, Bashkimi - Sigal Prishtina do të zhvillohet më 1 dhjetor.

SUPERLIGA - Java 12

Të shtunën takohen:
19:00 Ponte Prizreni - Rahoveci

Të dielën takohen:
17:00 Vëllaznimi - Golden Eagle Ylli
19:00 Trepça - Peja

Ndeshje derbi në Superligën e hendbollit

PEJË, 25 NËNTOR - Xhiroja e dhjetë sjellë ndeshje interesante e me rivalitet në Superligën e Kosovës në hendboll. Vëllaznimi - Deçani është ndeshja që e hap xhiron e radhës, ndërsa luhet të shtunën prej orës 18:00 në Gjakovë. Vëllaznimi është mobilizuar në kërkim të fitores së rëndësishme, ndërsa deçanasit e bëjnë udhëtimin e shkurtër me shpresë për dy pikë të reja. Vëllaznimi është i pesti në tabelë me gjashtë pikë nga shtatë ndeshje. Deçani është i teti (parafundit) me katër pikë nga tetë ndeshje, por synon shumë më tepër në vazhdim të kampionatit. Të shtunën janë edhe dy ndeshje të tjera që zhvillohen prej orës 19:00. Kampionia dhe liderja, Besa Famgas, e pret Trepçën në palestrën "Karagaçi" në Pejë. Ndeshja e parë mes këtyre dy skuadrave ishte interesante dhe e hapur thuajse deri në fund.



Shpresohet për një tjetër ndeshje të fortë dhe me rivalitet. Besa ka fituar tetë ndeshjet e deritashme dhe udhëheq me 16 pikë. Trepça është e treta me 12 pikë, ndërsa mori fitore të madhe fundjavën e kaluar në Vushtrri. Llapi - Rahoveci është ndeshja

tjetër e së shtunës mbrëma. "Vreshtarët" udhëtojnë për fitore, por llapjanët do të japin më të mirën në tentim për t'i mbajtur pikët. Të dielën është ndeshja Vushtrria - Kastrioti. Kjo ndeshje luhet prej orës 18:00 dhe, po ashtu, pritet të jetë me rivalitet.

SHKURT

Fenerbahçe rikthen interesimin për Shaqirin

Klubi i madh turk, Fenerbahçe, e ka rikthyer interesimin për yllin shqiptar Xherdan Shaqiri. Shaqiri momentalisht është me Zvicrën në Kampionatin Botëror "Katar 2022", ku veçse ka filluar shkëlqimin me asistim te goli i fitores 1-0 ndaj Kamerunit. Fenerbahçe synon ta fitojë titullin këtë sezon në Superligën e Turqisë dhe Shaqirin e sheh si një përforsim të madh në luftën drejt trofeut. Drejtuesit e klubit turk thuhet se do të tentojnë në afatin e janarit huazimin e futbollistit 31-vjeçar, i cili mund të luajë si numër 10 dhe në dy krahët e sulmit. Në anën tjetër, Shaqiri, i cili luan për skuadrën amerikane Chicago Fire, pasi ka bërë 36 paraqitje këtë sezon, duke shënuar 7 gola dhe regjistruar 8 asistime. Kontrata e Shaqirit me klubin skadon në vitin 2024, ndërsa vlera aktuale në treg është katër milionë euro. Shaqiri në karrierën e tij ka luajtur edhe për skuadra si Liverpool, Inter, Stoke City, Bayern Munich dhe Basel.

Trajneri i Brazilit: Neymari do të vazhdojë në Kupën e Botës

Brazili e mposhti Serbinë me rezultat 2-0 në ndeshjen e xhiros së parë në Kupën e Botës. Neymar ishte prej lojtarëve më të faulluar dhe më i padëshiruar edhe nga tifozët serbë. Nëntë nga 12 faullet e shkaktuar nga Serbia ishin në Neymarin, i cili mori edhe një lëndim që po e frikëson Brazilin. "Ai do të vazhdojë në Kupën e Botës, ju mund ta keni këtë siguri. Ai ndjeu dhimbje gjatë lojës, por vendosi të vazhdojë. Kjo duhet theksuar", ka thënë Tite.

Kupa e Botës, formacioni më i mirë pas ndeshjeve të para në grupe

Pas përfundimit të ndeshjeve të para në grupe, ku surprizat nuk kanë munguar, është përpiluar edhe një formacion i lojtarëve më të mirë. Vlerësimi i skuadrës më të mirë është bërë edhe në bazë të statistikave dhe votave që kanë marrë lojtarët pas ndeshjeve të para. Në këtë formacion dominon Spanja me tre futbollistë, ndjekur nga Franca e Brazili me nga dy futbollistë. Formacioni (4-3-3): Thibaut Courtois (Belgjikë), Danilo (Brazil); Hassan Al-Tambakti (Arabia Saudite); Jakub Kiwior (Poloni); Jordi Alba (Spanjë), Adrien Rabiot (Francë); Gavi (Spanjë); Jude Bellingham (Angli), Olivier Giroud (Francë); Richarlison (Brazil); Ferran Torres (Spanjë).

Vinicius Junior: Na presin edhe gjashtë finale

Ylli i Real Madridit, Vinicius Junior, pati një rol përcaktues në të dy golat e Brazilit në ndeshjen ndaj Serbisë që përfundoi 2-0. Futbollisti i talentuar ka thënë se tash brazilianët i presin edhe gjashtë finale të tjera për ta fituar Kupën e Botës. "Jam shumë i lumtur për debutimin tim dhe për fitoren, e nisëm këtë Botëror me këmbën e duhur. Kam pritur 22 vjet për të arritur deri këtu, shumë ëndrra, shumë punë. Jam shumë i lumtur që mund ta ndihmoj skuadrën. Tani na presin edhe 6 finale", ka thënë Vinicius Junior.

Verstappeni konfirmon: Garoj sërish me numrin 1

Piloti holandez Max Verstappen, kampion bote në Formula 1, ka konfirmuar se do ta mbajë sërish numrin 1 në makinën e tij. Verstappeni ka mbajtur dikur numrin 33, por

vjet kaloi në numrin 1, të cilin do ta mbajë edhe këtë sezon. "Po, do të garoj sërish me numrin 1", u shpreh piloti holandez i Red Bullit. "Për mua është numri më i mirë i

mundshëm me të cilin do të garoj për sa kohë kam mundësi. Nuk ndodh gjithnjë që të mbash këtë numër, që i takon vetëm kampionit të botës", ka thënë Verstappeni.

"Për sa kohë do të jem kampion dhe do ta mbroj titullin, nuk do ta ndryshoj numrin 1. Numrin 33 mund ta përdor sa herë të kem dëshirë. Unë synoj që edhe vitin tjetër të

jem kampion bote. E di që do të jetë një sezon më i fortë, por unë garoj për fitore dhe për ta nderuar numrin 1 të kampionit", ka deklaruar Verstappeni.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Greenium" Sh.p.k. Prishtinë, në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për imiantin-parku solar fotovoltai "Artana 1" 35.50 MW në Llabjan komuna e Novobërdës.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 23.12.2022 në ora 10:30 në hapësirat e restorant "NuovoMonte" Novobërdë/Artanë (përball kalas se Artanës) do të organizohet debat publik nga Kompania "Greenium" Sh.p.k. Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për imiantin-parku solar fotovoltai "Artana 1" 35.50 MW në Llabjan komuna e Novobërdës.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/74978664293?pwd=b3lPaTVISGFHUGhEWwtkbWhsUksrdz09>

Meeting ID: 749 7866 4293
Passcode: FhBsV6

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë "Greenium" Sh.p.k. Prishtinë për imiantin-parku solar fotovoltai "Artana 1" 35.50 MW në Llabjan komuna e Novobërdës.

https://mmphi.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publicimet/279/publicimet

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" Sh.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212), Vendimit të Bordit të datës 03.06.2022 për shpalljen e konkursit, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendit të punës për periudhën e ardhshme një vjeçare, KRM "Uniteti" SH.A vendosi që me datë 26.11.2022 të rishpall:

KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e vendeve të punës:

Tre (3) Punëtor Fizik -Njësia në Vushtrri me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeçare), me mundësi vazhdimi

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:

- Kryen të gjitha punët në mbledhjen dhe ngarkimin e mbeturinave në automjete – kamion kompaktor dhe traktor;
- Zbrazen e konteinerëve dhe pastrimin e lokacionit rreth tyre nga zona e shërbimit gjerë në deponi;
- Kryen pastrimin, larjen dhe spërkatjen e sipërfaqeve publike, rrugëve dhe shesheve;
- Kryen punët e grumbullimit të mbeturinave në konteiner, kryen punët rreth pastrimit të borës, hedhjes së kripës industriale, heqjen e akullit;
- Është i obliguar të ketë sjellje korrekte ndaj qytetarëve dhe shfrytëzuesve të shërbimeve;
- Është përgjegjës për përdorim të kujdesshëm të konteinerëve gjatë punës, kryen edhe punë tjera të natyrës së ngajshme të cilat i cakton udhëheqësi i tij i drejtëpërdrejtë.

Kualifikimet e kërkuara:

- Të ketë diplomën e shkollës fillore ose të mesme;
- Të prezantoj leternjoftimin;
- Çertifikatë mjeksore (me rastin e lidhjes së kontratës).

Kushtet e veçanta:

Punëtori gjashtë (6) muajt e parë do të jetë në punë provuese, dhe varësisht nga performanca e tij do të vazhdohet apo përtrihet kontrata e punës.

Aplikacionin së bashku me diplomën, referencat etj. mund të dorëzohen në Zyrën e Arkivës, në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "Uniteti" Sh.A. Mitrovicë. Konkursi do të jetë i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore prej 26.11.2022 deri më datën 10.12.2022. Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Komisionit Vlerësues. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhet pas përfundimit të afatit të aplikimit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Greenium" Sh.p.k. Prishtinë, në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për imiantin parku solar fotovoltai "Artana2" 43.86 MW në Llabjan komuna e Novobërdës.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 23.12.2022 në ora 11:00 në hapësirat e restorant "NuovoMonte" Novobërdë/Artanë (përball kalas se Artanës) do të organizohet debat publik nga Kompania "Greenium" Sh.p.k. Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për imiantin parku solar fotovoltai "Artana2" 43.86 MW në Llabjan komuna e Novobërdës.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/74978664293?pwd=b3lPaTVISGFHUGhEWwtkbWhsUksrdz09>

Meeting ID: 749 7866 4293
Passcode: FhBsV6

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë "Greenium" Sh.p.k. Prishtinë për imiantin parku solar fotovoltai "Artana2" 43.86 MW në Llabjan komuna e Novobërdës.

https://mmphi.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publicimet/279/publicimet

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Orhan Baxhaku shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

Fatlind Shigjeqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmU " Vëllezërit Frashëri " Pllaneje.

Behajdin Bajraktari shpall te pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

Fatlind Morina nga Ratkoci KK Rahovec shpall të pavlefshme dëftesat e SH.F.M.U. "4 Dëshmorët" Retkoc KK Rahovec nga kl. I-V dhe IV-IX.

Petrit Rakoci nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I,II,III, të SH.M.Teknike "Nexhmedin Nixha Gjakovë.

- Infermierja e përgjithshme, Rabe Nikçi nga komuna Pejës me numër personal 1003700182, shpalli të humbur Licencën e Punës me numër: KO-3462-05-20, me afat prej 03.01.2018 deri 03.01.2023.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanë me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA



INSTITUTI I HISTORISË "ALI HADRI" - PRISHTINË
INSTITUTE OF HISTORY "ALI HADRI" - PRISHTINA
INSTITUT ZA ISTORIJU "ALI HADRI" - PRISHTINA
GOVERNMENT OF KOSOVA

Prishtinë, 26.11.2022

Në bazë të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2013), neni 35, Statutit të Institutit të Historisë "Ali Hadri" në Prishtinë, neni 32, Ligjit të Punës nr. 03/L212 neni 8, dhe Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve të Institutit të Historisë, shpallë:

KONKURS

1. Një Hulumtues të pavarur për shek.XVI-XVIII –rizgjedhje

Kandidatët për pozitën Hulumtues i pavarur duhet të plotësojnë këto kushte:

- Të ketë të regjistruara studimet e doktoraturës për periudhën përkatëse,
- Të ketë punime të publikuara në revista shkencore nga periudha e caktuar,
- Të ketë pjesëmarrje në aktivitete shkencore brenda dhe jashtë vendit.

Dokumentacioni i nevojshëm

Kandidati/ja duhet të dorëzojë dokumentacionin si vijon:

- Vërtetimin për vijimin e studimeve të doktoraturës
- Diplomën për përfundimin e studimeve përkatëse (MA),
- Certifikatën e lindjes jo më të vjetër se gjashtë muaj,
- Dokument të lëshuar nga organi kompetent me të cilin dëshmohet që nuk janë nën hetime,
- CV të së cilës duhet t'i bashkëngjiten dëshmitë e nevojshme për të vërtetuar gjendjen e paraqitur në të.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor nga Instituti, dhe janë të obliguar të sjellin me vete dokumentet origjinale mbi kualifikimet dhe trajnimet e kryera për verifikim para Komisionit.

Për informata të hollësishme mund të kontaktoni në këtë nr. tel: 038/512 - 303, prej orës 08:00 - 16:00. Aplikacionet e kompletuara dorëzohen në adresën: Instituti i Historisë në Prishtinë, rr. "Muharrem Fejza", pa numër (Ndërtesa e Arkivit të Kosovës).



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVA



INSTITUTI I HISTORISË "ALI HADRI" - PRISHTINË
INSTITUTE OF HISTORY "ALI HADRI" - PRISHTINA
INSTITUT ZA ISTORIJU "ALI HADRI" - PRISHTINA

Prishtinë, 26.11.2022

Na osnovu Zakona br. 04/L-135 o naučnoistraživačkoj djelatnosti - (Službene Novine Republike Kosova, br 11/02 Maj 2013), Član 35, Statuta Instituta za Istoriju "Ali Hadri" u Prištini, član 32; Zakon Br. 03/L-212 o Radu, i Uredba o postupcima za izbor i reizbor naučnih radnika i istraživača Instituta za istoriju, objaviti:

KONKURS

1 (Jedan) Nezavisni istraživači za XVI-XVIII vekove- izbor

Kandidati za Nezavisna istraživač moraju ispuniti ove uslove:

- Upisane doktorske studije za navedeni period.
- Objavljene radove u naučnim časopisima iz navedenog perioda;
- Da su učestvovali u naučnim aktivnostima u zemlji i u inostranstvu.

Potrebna dokumentacija:

Kandidati treba da dostave sledeću dokumentaciju:

- Potvrda koja dokazuje da pohađja doktorske studije,
- Diploma za završetak relevantnih studija (MA)
- Izvod iz matične knjige rođenih koji nije stariji od šest meseci,
- Dokument izdat od nadležnog organa koji potvrđuje da nisu pod istragom,
- CV o čemu mora priložiti neophodne dokaze kako bi se dokazala situacija u njoj.

Rok za prijavu je 15 dana od dana objavljivanja u dnevnom novinama, Aplikaciji se prilažu (dodajte) kopije dokumentacije o kvalifikaciji, iskustvu i drugoj potrebnoj dokumentaciji koju zahteva radno mesto za koje se aplicira.

Kandidati izabrani na izbornoj listi će biti obavješteni u pisanom obliku ili putem telefona u zakonskom roku Instituta i dužni su da sa sobom daju originalne dokumente o kvalifikacijama i obuci koja se provode za verifikaciju pred Komisijom.

Za detaljnije informacije možete se obratiti na ovom Br . Tel: 038 / 512 303, od 09:00 do 16:00 časova.

Kompletirani zahtevi dostavljaju se na adresu : Institut za Istoriju u Prištini , ul. "Muharam Fejza "bez broja (Zgrada Kosovske Arhive).

